




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VAU DEJËS  
KËSHILLI BASHKIAK



VENDIM

Nr. 31 Datë 29.03 2023

**“Për dhënien e titullit “ Qytetar Nderi” i Bashkisë Vau Dejës, Z. Romeo Zuppa , Z. Santi Di Gangi, Zj. Maria Pia Zuppa, Z. Silvio Sibille , Z. Llesh Frroku dhe të ndjerit Shykri Kapllani ”**

Në mbështetje të Ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar ; neni 9, pika 1.7, gërma a), neni 54, gërma m); Ligji nr 94/2023 “ Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”. Neni 8, neni 9; neni 11, pika 2 gërma a; neni 13, neni 18, Këshilli i Bashkisë:

**VENDOSI:**

1. Dhënia e titullit “ Qytetar Nderi” i Bashkisë Vau Dejës , Romeo Zuppa ( shtetas i huaj).  
Me motivacionin: “Për kontributin fetar dhe shoqëror, si njerëz që kanë mbajtur dhe përcjellë vlera fetare dhe humanitare”
2. Dhënia e titullit “ Qytetar Nderi” i Bashkisë Vau Dejës . Santi Di Gangi ( shtetas i huaj).  
Me motivacionin: “Për kontributin shoqëror dhe humanitar, në ndihmë të emigrantëve shqiptar, që nga viti 1991 dhe në vazhdim”.
3. Dhënia e titullit “ Qytetar Nderi” i Bashkisë Vau Dejës , Maria Pia Zuppa ( shtetas i huaj). Me motivacionin: “Për kontributin fetar dhe shoqëror, si njerëz që kanë mbajtur dhe përcjellë vlera fetare dhe humanitare”
4. Dhënia e titullit “ Qytetar Nderi” i Bashkisë Vau Dejës , Silvio Sibille ( shtetas i huaj).  
Me motivacionin: “Për kontributin fetar dhe shoqëror, si njerëz që kanë mbajtur dhe përcjellë vlera fetare dhe humanitare”
5. Dhënia e titullit “ Qytetar Nderi” i Bashkisë Vau Dejës , pas vdekjes të ndjerit Shykri Kapllani.

Me motivacionin: "Për kontributin fetar dhe shoqëror, si njerëz që kanë mbajtur dhe përcjellë vlera fetare dhe humanitare"

6. Llesh Frroku, me motivacionin "Për kontribute dhe vlera në fushën arsimore e kulturore"
7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Vau Dejës dhe Sekretaria e Bashkisë Vau Dejës, duke qenë se është akt me karakter individual dhe hyn në fuqi pas njoftimit të subjekteve që përfshihen në to.
8. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

**KRYETAR**

**Mark BISHA**

**Sekretar i Këshillit Bashkiak**

**Ardian ÇELEPIJA**



Miratuar me 19 vota

Vota Pro 19

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 03.04.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJES  
KRYETARI

Nr 1830/ Prot

Vau Dejes, me 13 . 03 . 2023

**PROPOZIM PËR DHËNIEN E TITUJVE TË NDERIT**

Bazuar në Ligjin 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, përkatësisht Neni 9, pika 1.7, gërma a), neni 54 gërma m);

**Neni 9, pika 1.7, gërma a)**... . *Të drejtat dhe përgjegjësitë, 1.7. Të drejta të tjera, sipas të cilave:*  
*a) japin tituj nderi dhe stimuj;*

**Neni 54 gërma m)** *Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak, m) jep tituj nderi dhe stimuj;*

Ligji nr 94/2023 “ Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”,  
KREU III / Neni 8, neni 9; KREU IV / neni 11, pika 2 gërma a; neni 13:

**Neni 8, Llojet e titujve vendorë të nderit** ... *Titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë janë titulli “Qytetar nderi” dhe tituj të veçantë vendorë nderi që jepen sipas përcaktimeve të këtij ligji.*

**Neni 9, Titulli “Qytetar nderi”** 1. *Titulli “Qytetar nderi” jepet nga këshilli bashkiak për veprimtari të shquar, kontribute dhe merita të veçanta në shërbim dhe në dobi të bashkisë ose për veprimtari për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të komunitetit brenda territorit të bashkisë.*  
2. *Titulli “Qytetar nderi” u jepet edhe personaliteteve të huaja të nivelit të lartë, që vizitojnë një bashki në kuadër të një vizite zyrtare ose shtetërore.*

**Neni 11, pika 2** , *Propozimi për dhënie e titullit vendor të nderit paraqitet nga: a) kryetari i bashkisë;*

**Neni 13, Propozimi për nderim**

Mbështetur në legjislacionin e parashikuar për dhënie e titujve të nderit, duke e respektuar parashikimet e tij, duke u legjitimuar nga neni 11, pika 2 e Ligjit nr 94/2023, propozoj dhënie e titullit “ Qytetar nderi” për disa personalitete , si më poshtë :

Don Romeo Zuppa ( Shtetas i huaj), propozohet ti jepet titulli “ Qytetar nderi”, me motivacionin “*Për kontributin fetar dhe shoqëror, si njerëz që kanë mbajtur dhe përcjellë vlera fetare dhe humanitare*”.

Santi Di Gangi ( Shtetas i huaj), propozohet ti jepet titulli “ Qytetar nderi”, me motivacionin “*Për kontributin shoqëror dhe humanitar, në ndihmë të emigrantëve shqiptar, që nga viti 1991 dhe në vazhdim*”.

Maria Pia Zuppa ( Shtetas i huaj), propozohet ti jepet titulli “ Qytetar nderi”, me motivacionin “*Për kontributin fetar dhe shoqëror, si njerëz që kanë mbajtur dhe përcjellë vlera fetare dhe humanitare*”.

Silvio Sibille( Shtetas i huaj), propozohet ti jepet titulli “ Qytetar nderi”, me motivacionin “*Për kontributin fetar dhe shoqëror, si njerëz që kanë mbajtur dhe përcjellë vlera fetare dhe humanitare*”.

Historik i shkurtër i veprimtarive të tyre:

Gjyshi nga babai i Don Romeo Zuppa, i ndjeri Antonio Zuppa, ishte me origjinë shqiptare dhe fliste shqip. Familja Zuppa ka qenë një nder 18 familjet shqiptare që kanë lënë token e tyre në vitin 1743 dhe janë vendosur në disa zona të caktuara nga Mbreti Charles III , ky qytet quhet Villa Badessa dhe është pjesë e komunës së Roscianos në provincën e Pescara-s në Italinë Qendrore. Nga këto familje shumë prej tyre , kanë ruajtur shumë nga traditat e tyre shqiptare dhe gjuhën shqiptare, për me tepër në Kishën e qytetit e Villa Badessa , ruhen një koleksion shumë i pasur i ikonave bizantine. Gjuha shqipe dhe traditat shqiptare e kanë shtyrë atë që të vijë për vizita në shqipëri, duke filluar në këtë mënyrë një marrëdhënie me shqipërinë. Në vitin 2007, Don Romeo Zuppa, Santi Di Gangi, Maria Pia Zuppa dhe Silvio Sibille kanë dhënë ndihmë të konsiderueshme në ndërtimin e kishës së Shen Nikollës , ku me atë famulli kishin hyrë dhe një binjakëzim shpirtëror. Silvio Sibille dhe Maria Pia Zuppa, kanë pasur një marrëdhënie të vecante bashkëpunimi me motrat misionare Franceskane të Shkodrës e cila vazhdon dhe sot. Keta persona kanë kontribuar në Kishën e re të Naracit dhe vazhdojnë të kontribuojnë edhe sot nëpërmjet Dom Emiljanit.

Santi Di Gangi, gjithashtu ka qenë mbështetës i emigrantëve shqiptarë , të cilët gjatë viteve të demokracisë emigruan për nevojat e tyre në shtetin Italian, duke i pritur në shtëpitë e tyre dhe duke ndihmuar në integrimin e tyre në shoqëri, që nga viti 1991 dhe në vazhdim. Pra, ka mbrojtur dhe promovuar interesat e komunitetit shqiptar dhe për me tepër banor të Bashkisë Vau Dejës.

Shykri Kapllani ( Pas vdekjes), propozohet ti jepet titulli “ Qytetar nderi” me motivacionin “*Për kontributin fetar dhe shoqëror, si njerëz që kanë mbajtur dhe përcjellë vlera fetare dhe humanitare*”

I ndjeri Shykri Kapllani, i lindur me 01.05.1955, ka ndërruar jetë me datë 31.08.2021,i ndjeri ka qenë hoxhë në njësinë Administrative Bushat që nga viti 1991, duke kontribuar në aspektin fetar dhe shoqëror, duke nxitur paqen dhe harmoninë fetare, duke ndihmuar për sa ka qenë e mundur të gjithë nevojtarët pa u dalluar nga ngjyrat fetare.

Xhamia ku ai ka shërbyer, ka ndikuar në formësimin dhe mbrojtjen e identitetit të komunitetit mysliman. Në radhë të parë është përdorur si vend për lutje, përkatësisht për faljen e pesë kohëve të namazit. Ka shërbyer si ent arsimit dhe edukimi, që do të thotë se shërbimet e saj kanë qenë shumëdimensionale. Me fjalë të tjera xhamia ku ai shërbente kishte rolin e një qendre shpirtërore, ku janë gërrshetur vlera të jetës shpirtërore dhe të botës materiale. ka shërbyer si një universitet

gjithë popullor, si shtyllë kryesore e vlerave të jetës, duke i orientuar myslimanët drejt përsosjes së vlerave fetare, kombëtare, shpirtërore, edukative, arsimore, kulturore etj. Ka qenë person që ka promovuar vlerat e barazisë së plotë, në të cilat aspak nuk ka rëndësi statusi social dhe qytetar i individit. Diskriminimi në to ka qenë inekzistent, si Shtëpi e Allahut, nuk i përket një etnikumi të caktuar por i përket të gjithë myslimanëve pa dallim race, kombi dhe gjuhe.

Llesh Gjin Frroku , propozohet ti jepet titulli “ Qytetar nderi”, me motivacionin “*Për kontribute dhe vlera në fushën arsimore e kulturore*”

Llesh Gjin Frroku, i lindur në vitin 1928, banues ne Hajmel, Njësia Administrative Hajmel, Bashkia Vau Dejes, veteran i luftës dhe mesues për 36 vite, në Mirditë , Pukë dhe në Qarkun e Shkodrës. Llesh Frroku është nje personalitet, që gjatë jetës së tij, ruajti përkushtimin dhe respektin ndaj mësuesve të tij, duke i shërbyer më vonë, gjatë punës së tij, po ashtu si mësues, si model në punë dhe angazhimin e tij me nxënës, duke përcjellë tek nxënësit e tij një model të përkushtuar dhe të veçantë mësuesi dhe pedagogu për kohën. Lleshi filloi punën si mësues në periudhat më të vështira dhe në vazhdim, mësuesi Llesh mësoi një numër të konsiderueshëm të nxënësve të cilët vinin nga fshatra të ndryshme. Ai la përshtypje të pashlyeshme tek nxënësit që ai i mësoi. Në atë kohë kushtet ishin të vështira, nxënësve u mungoni fletoret, lapsat dhe mjetet tjera të nevojshme për mësim. Frytet e punës së mësuesit Llesh Frroku, dhe të mësuesve të tjerë të cilët punuan në ato periudha bënë që prej duarve të tyre të dalin intelektualë dhe personalitete të shquara.

**KRYETARI**

**Mark Babani**

